



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 95 Prot.

Tiranë, më 25.01 2017

VENDIM Nr. 1, datë 24.01.2017

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 1 të datës 24.01.2017, pasi shqyrtoi *Kërkesën e Institutit të Arkeologjisë për ndryshim të vendimit Nr. 128, datë 22.11.2016* të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë për projektin "Sheshi publik para hyrjes së Portit të Durrësit", Bashkia Durrës,

VENDOSI:

1. Të miratojë *Kërkesën e Institutit të Arkeologjisë për ndryshim të vendimit Nr. 128, datë 22.11.2016* të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë për projektin "Sheshi publik para hyrjes së Portit të Durrësit", Bashkia Durrës.
2. Pas verifikimit në terren të zonës, ku do të zbatohet projekti i sipërpërmendur, grupi i specialistëve të Institutit të Arkeologjisë dhe Bashkisë Durrës, konstatuan që muri rrethues antik është poshtë kuotës të zbatimit të projektit dhe nuk preket nga ai.
Kuota e sistemit të ky mur, të realizohet me mbushje çakëlli dhe jo me beton.
3. Duke mos patur gjurmë në thellësi, bie poshtë *Koncepti i e ndërhyrjes arkeologjike i miratuar me vendim Nr. 128, datë 22.11.2016*, por punimet e zbatimit të projektit të monitorohen në mënyrë të vazhdueshme.
4. Instituti i Arkeologjisë në bashkëpunim me DRKK Durrës të kryejnë monitorimin e punimeve të zbatimit të projektit.
5. Investitori duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me Institutin e Arkeologjisë që do monitorojë punimet e zbatimit për këtë projekt dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, që do të realizojë mbikqyrjen e tij.
6. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.



7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
8. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARSKA
MINISTRE
MINISTRI
TIRANË



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO